



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400368/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për kthimin dhe dorëzimin e mjetit motorçikletë, marka "YAMAHA", me targë AE070, me nr. shasje JYARN126000001245 shtetasit K.I.*

Drejtuar : **Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 4
Z. Alban AHMETI**

Tiranë

I nderuar Zoti Ahmeti,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi K.I. me banim në Selitë, Tiranë. Ankuesi shkruan se është pronarë i një mjeti, motorçikletë, marka "YAMAHA", me targë AE070, me nr. shasje JYARN126000001245. Para disa muajsh motorçikletën ai ia ka dhënë në përdorim shtetasit I.Ç.. Në datën 04.09.2013 motorçikleta është bllokuar përdoruesit I.Ç. nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë sepse ai është kapur në kundërvajtje duke qarkulluar pa dokumentacionin e kërkuar nga ligji.

Ankuesi pretendon se megjithëse ka shkuar disa herë në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë dhe ka çuar dokumentat e mjetit të tij, por mjeti nuk i është kthyer e dhënë në dorëzim.

Meqënëse është privuar padrejtësisht nga e drejta e gëzimit të sendit që ka në pronësi kërkon ndërhyrjen e institucionit tonë për të mundësuar kthimin dhe dorëzimin e mjetit pronë të tij.

Së bashku me ankesën ankuesi na ka dërguar edhe fotokopje të dokumentacionit të mjetit të tij motorçikletë, marka "YAMAHA", me targë AE070, me nr. shasje JYARN126000001245, si lejen e qarkullimit dhe policën e sigurimit të detyrueshën të mjetit.

Për shqyrtimin e kësaj ankesë, në datën 07.03.2014 nga Nd/Komisioneri ynë i ngarkuar për ndjekjen e këtij rasti u bënë verifikime në vend të dokumentacionit të administruar nga Komisarati i Policisë Nr. 4 Tiranë. Nga këqyrja e dokumentacionit, regjistrin të mjeteve të bllokuara provizorisht në këtë

komisariat rezultoi se, bllokimi i mjetit të ankuesit është bërë me procesverbalin e mbajtur në datën 04.09.2013. Mjeti i është bllokuar drejtuesit të tij, shtetasit I.Ç., për mungesë dokumentash.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese institucioni ynë ka arritur në konkluzionin se ankesa e shtetasit K.I. është e drejtë. Ndonëse veprimi i organit të policisë për bllokimin e mjetit për shkak të mungesës së dokumentacionit është i bazuar në Kodin Rrugor, por qëndrimi i punonjësve të policisë më vonë duke mos ia dhënë në dorëzim mjetin pasi ai ka sjellë dokumentacionin e nevojshëm nuk është korrekt. Me këtë qëndrim atij i janë shkelur të drejtat e garantuara nga; Kushtetuta neni 41/1 ku thuhet se: *“E drejta e pronës private është e garantuar”* dhe neni 42/1 ku thuhet se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligji nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”*; si dhe dispozitat e Kodit Civil për të drejtën e pronësisë për të gëzuar e disponuar lirisht sendin.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në të cilin thuhet se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjehershme për kthimin dhe dorëzimin e mjetit motorçikletë, marka “YAMAHA”, me targë AE070, me nr. shasie JYARN126000001245 pronarit të tij shtetasit K.I..

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni në zbatim të tij, na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe Porosi
Nd/KOMISIONER

Frederik PASKALI